



Në bazë të dispozitave të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji nr.03/L-040, Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr.28/2008 dhe neni 5 pika 2 të Ligjit për Zonë Ekonomike me Nr.04/L-159 dhe neni 36.1 dhe 36.2 të Statutit të Komunës së Vitisë me nr. 01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 08.12.2015 aprovon këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E ZONËS EKONOMIKE NË KUADER TË ZK BUDRIKË E EPËRME

Pranuar - Primen në datë 10.12.2015			
Nr. i origjinalit	Num.	Titulli	Vlera
01-013/1640			

Neni 1

Me qëllim të vendosjes së rregullave për shfrytëzimin e zonave ekonomike për mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe punësim në nivelin komunal, me këtë vendim shpallet zona ekonomike me statusin "Parku Industrial" në kuadër të zonës kadastrale në Budrikë.

Neni 2

Zona ekonomike me statusin "Parku Industrial", sipas nenit 1 definon territorin në të cilin është e koncentruar parcelat kadastrale si tërësi e zonës si vijon:

- P-70101012-00641-1, në vendin e quajtur "Batanica" me kulturë kullosë e klasit të tretë, me sipërfaqe përafërsisht prej: 15.50,00 ha, në zonën kadastrale në Budrikë e Epërme në pronësi të Komunës së Vitisë.

Neni 3

Me këtë vendim definohet shtrirja gjeografike e zonës ekonomike e koncentruar në pjesën perëndimore të komunës, përkatësisht parcelat kadastrale me pozitë pronë dhe madhësi sipas nenit 2, në sipërfaqe të përgjithshme përafërsisht prej 15.50,00 ha, e cila është e specifikuar në hartën treguese, që i bashkëngjitet këtij Vendimi.

Neni 4

Kjo zone definon llojin e veprimtarisë, që do të zhvillohet në kuadër të saj, që rezulton në veprimtari të prodhuese, industrial dhe agropërpunim, veprimtari tregtare, import - eksport dhe shërbime.

Neni 5

Obligohet Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, që të hartoj Rregulloren e veçantë për definimin e kushteve të përgjithshme të procesit zhvillimor, që rezulton në funksionimi dhe zhvillimin e bazuar në rregullativën ligjor për zonat ekonomike dhe investime, që për bazë do të ketë:

Krijimin e një instrumenti rregullues dhe të thjeshtë, efikas, i cili do të mund të aplikohet sa me shpejtë të jetë e mundur dhe do të jetë i ndjeshëm ndaj zhvillimit dhe përcaktimeve të mëtejshme të zhvillimit ekonomik, si përkushtim i pushtetit lokal.

Neni 6

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit që të përgatisë detyrën programore për hartimin e Planit Zhvillimore Urban për këtë zonë, që rezulton në përcaktimin e kushteve të përgjithshme të planifikimit dhe rregullimit të hapësirës, si dhe do të zhvilloj procedurat tjera në harmoni me rregullativën ligjor të planifikimit dhe ndërtimit.

Neni 7

Shpallja e Zonës Ekonomike sipas këtij vendimi dhe obligimet e organeve kompetente për procesin e zbatimit duhet të rezultojnë në realizimin e objektivave strategjike, si:

- Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm për biznese.
- Krijimi i vendeve të reja punës për zbutjen e situatës sociale dhe rritje domethënëse të vlerave të punësimit.
- Ofrimi i një force pune të kualifikuar dhe fleksibile, bizneseve të këtyre zonave.
- Fokusimin e drejtë të investimeve të reja në veprimtaritë ekonomike.
- Krijimin e një rrjeti transporti të qëndrueshëm dhe që përmbush nevojat për zhvillimin e këtyre zonave.
- Promovimin e paketave informuese për këto zona në tregun lokal, rajonal dhe me gjerë.

Neni 8

Dokumentet nga neni 5 dhe neni 6 do të vihen në shqyrtim publik dhe komentim, shqyrtimi publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallet në mjetet e informimit.

Neni 9

Për hartimin e dokumenteve nga neni 6 do të kujdeset Komuna së Vitisë, gjegjësisht zyra për hartimin e projekteve, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik .

Neni 10

Ky vendim, hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal i Vitisë.

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Dira

